



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



KRYETARI I KRYEQYTETIT

14-020/04-98979/26, me 06 JUL 2026

Në bazë të dispozitave të nenit 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L – 040, për Vetëqeverisje Lokale, nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.02.2010, nenit 20 të Ligjit nr.06/L-084 për të Drejtat e Fëmijës dhe neneve 5, 6, 7 dhe 8 të Udhëzimit Administrativ (QRK) nr. 06/2022 për themelimin dhe funksionimin e ekipit për të drejtat e fëmijës, Kryetari i Kryeqytetit, merr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Ekipi për të Drejtat e Fëmijës.
2. Sipas pikës 1 të këtij Vendimi, Ekipi ka këtë përbërje:
 1. Kryesues - Nënkryetarja - Besiana Musmurati;
 2. Zv/Kryesues - Drejtoresha e Mirëqenies Sociale - Adelinë Sahiti – anëtare;
 3. Drejtorja e Arsimit - Fatbaradha Azizi - anëtare;
 4. Drejtorja e Shëndetësisë - Arbnora Sahiti – anëtare;
 5. Drejtorja për Rini, Kulturë dhe Sport, Bardh Avdiu – anëtar;
 6. Drejtorja e Financave - Anita Jashari – anëtare;
 7. Anëtar i deleguar nga Komiteti për komunitete i Kuvendit të Komunës, – Fjolla Vukshinaj, anëtare;
 8. Zyra për Komunitete dhe Kthim - Slavica Stolić; anëtare;
 9. Zyrtari për mbrojtje të fëmijës-Njësia për të Drejta të Njeriut, Premtime Preniqi, anëtare;
 10. Policia, - Selvete Krasniqi, anëtare;
 11. Qendra për Pune Sociale - Bajram Shala- anëtar;
 12. Përfaqësues nga Shoqëria Civile - Donjeta Kelmendi (KOMF), anëtare.
3. Në cilësinë e anëtarëve, vëzhgues të jashtëm, janë:
 1. Përfaqësuesi i fëmijëve apo grupit të fëmijëve;
 2. Kryetari i Këshillit të Prindërve;
 3. Përfaqësuesi nga zyra rajonale e Institucionit të Avokatit të Popullit;
 4. Përfaqësuesi i organizatave vendore dhe ndërkombëtare.

4. Detyrat dhe punët e Ekipit për të drejtat e fëmijës, janë të përshkruara në nenin 20 të Ligjit nr.06/L-084 për të Drejtat e Fëmijës dhe nenin 7 të Udhëzimit Administrativ (QRK) nr. 06/2022 për themelimin dhe funksionimin e ekipit për të drejtat e fëmijës.
5. Ekipi takohet së paku një herë në tre (3) muaj, ndërsa mund të takohet edhe më shpesh me kërkesë të kryesuesit, apo me kërkesën e së paku 1/3 e anëtarëve.
6. Ekipi raporton tek Ministria Përgjegjëse për Qeverisje Lokale në baza gjashtë (6) mujore.
7. Për mbështetje administrative teknike, Sekretari e Ekipit caktohet Njësia për të drejtat e njeriut pranë Komunës.
8. Detyrat dhe përgjegjësitë e Sekretarisë janë të përcaktuara në nenin 12 të Udhëzimit Administrativ (QRK) nr. 06/2022 për themelimin dhe funksionimin e ekipit për të drejtat e fëmijës.
9. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

U dorëzohet:

- Anëtarëve të Ekipit;
- Qendrës për Shërbim me Qytetarë;
- Në dosje.

KRYETARI I KRYEQYTETIT
Përparim Rama

